



DEKLARATA E TË DREJTAVE

I dorëzohet një personi të vendosur nën arrest

Aktet terroriste

(nën. 63-1, 706-73 dhe 706-88 të kodit të procedurës penale)

Informacionet e mësipërme duhet t'ju jepen në një gjuhë që ju e kuptoni

Ju mund të ruani këtë dokument gjatë gjithë kohëzgjatjes së mbajtjes nën arrest

Jeni informuar se jeni vendosur nën arrest sepse ekzistojnë kundër jush një ose më shumë arsye të besueshme për të dyshuar se ju keni kryer ose jeni përpjekur të kryeni një krim ose kundërvajtje penale që përbën akt terrorist.

Ju do të dëgjoheni mbi këto fakte gjatë mbajtjes në arrest që mund të zgjasë 24 orë.

Ju keni të drejtë të njihni kualifikimin, datën dhe vendin e supozuar të kryerjes së veprës penale për të cilën ju jeni akuzuar dhe arsyet justifikuese të vendosjes suaj nën arrest.

Në fund të kësaj periudhe, prokurori ose gjyqtari i hetimeve paraprake do të mund të vendosë për zgjatjen e mbajtjes në arrest me njëzet e katër orë të tjera. Përpos në rast pamundësie, ju do të paraqiteni përpara këtij gjyqtari, nëse vlerësohet të jetë është e nevojshme, me anë të një video-konference.

Vetëm në rast të jashtëzakonshëm, dhe nëse kërkohet për nevoja të hetimit, dy zgjatje shtesë mund të vendosen, për një periudhë kohore prej njëzet e katër orësh secila, qoftë nga gjyqtari i lirive dhe ndalimit me kërkesë të prokurorit, qoftë nga gjyqtari i hetimeve paraprake.

Megjithatë, në qoftë e justifikon se kohëzgjatja e parashikuar e hetimeve të mbetura pas dyzet e tetë orëve të para, gjyqtari i lirive dhe i ndalimit me kërkesë të prokurorit ose gjyqtarit të hetimeve paraprake do të mund të vendosë që mbajtja nën arrest të mos zgjatet përveç se një herë për një kohëzgjatje prej dyzet e tetë orësh.

Në fund, nëse në bazë të elementeve të para hetimore ose të mbajtjes nën arrest konstatohet se ekziston një rrezik serioz për kërcënim nga një akti terrorist në Francë ose jashtë saj, ose nëse kërkohet domosdoshmërisht për nevoja të bashkëpunimit ndërkombëtar, gjyqtari (i lirive dhe i ndalimit) mund të autorizojë, me vendim të shkruar dhe të motivuar, me kërkesë të prokurorit ose me urdhëresë të gjyqtarit të hetimeve paraprake dhe në kuadër të një përjashtimi, që masa e ndalimit në fuqi t'i nënshtrohet një zgjatjeje të mëtejshme prej njëzet e katër orësh, me një mundësi ripërtëritje

Në fund të periudhës së paraburgimit, me urdhër të prokurorit (ose gjyqtarit të hetimeve paraprake), ju ose do të paraqiteni përpara këtij magjistrati, ose do të liroheni. Në rastin e parë, ju do të paraqiteni përpara një gjyqtari në rastin më të largët pas 20 orësh duke filluar nga përfundimi i mbajtjes tuaj nën arrest, me përjashtim të rastit kur mbajtja juaj nën arrest ka zgjatur më shumë se 72 orë.

GJITHASHTU JU INFORMOJMË SE KENI TË DREJTËN TË :

Lajmëroni disa persona të caktuar

Ju mund të kërkonit të flisni në telefon me një person me të cilin ju jetoni zakonisht ose me një nga prindërit tuaj në linjë direkte, ose me një nga vëllezërit ose motrat tuaja, ose me kujdestarin apo mbrojtësin tuaj, lidhur me masën e mbajtjes nën arrest subjekt i së cilës jeni ju vetë.

Gjithashtu ju mund të njoftoni punëdhënësin tuaj.

Nëse keni kombësi të huaj, ju gjithashtu mund të njoftoni autoritetet konsullore të vendit tuaj.

Prokurori ose gjyqtari i hetimeve paraprake mund të kundërshtojnë këtë kërkesë për arsye hetimore.

Me përjashtim të rrethanave të pakapërcyeshme, këto kërkesa do të ekzekutohen pas një maksimumi prej 3 orësh duke filluar nga momenti kur keni formuluar kërkesën tuaj

Në rast se nuk pranohet kërkesa juaj për të njoftuar një nga të afërmit tuaj, dhe në rastin e hipotezës kur masa e mbajtjes suaj nën arrest është zgjatur përtej orës së njëzet e gjashtë, ju mund të përsërisni kërkesën tuaj duke filluar nga ora e njëzet e gjashtë. Megjithatë, prokurori ose gjyqtari i hetimeve paraprake mund të kundërshtojnë këtë kërkesë për arsye hetimore.

Kontrollim nga një mjek

Ju mund të kërkonti të vizitoheni nga një mjek që në fillim të mbajtjes nën arrest dhe në rast të kohëzgjatjes së masës. Gjatë çdo zgjatje të mëtejshme që mund të autorizohet, ju do të vizitoheni detyrimisht nga një mjek dhe do t'ju komunikohet e drejta për një vizitë të re mjekësore.

Dhënie e deklaratave, përgjigja ndaj pyetjeve ose ruajtja e heshtjes

Pasi keni deklaruar identitetin tuaj, ju keni të drejtën, gjatë marrjes suaj në pyetje :

- të jipni deklaratat,
- t'i përgjigjeni pyetjeve që ju janë drejtuar,
- ose të heshtni.

Takimi me një avokat

- Zgjedhja e avokatit:

Që prej fillimit të mbajtjes nën arrest ju mund të kërkonti asistencën e një avokati të zgjedhur nga ju. Nëse ju nuk jeni në gjendje të caktoni një avokat ose nëse avokati i zgjedhur nuk mund të kontaktohet, ju mund të kërkonti që të takoni një avokat të caktuar kryesisht.

Avokati juaj mund të caktohet gjithashtu nga njërin prej personave që keni njoftuar : në këtë rast, ju duhet të konfirmoni caktimin e avokatit.

- Asistenca e avokatit:

Avokati i caktuar do të mundet:

- të takohet me ju gjatë 30 minutave në kushtet që garantojnë konfidencialitetin e takimit; Në rast zgjatjeje, ju mund të kërkonti përsëri të takoheni me të që prej fillimit të kësaj zgjatjeje.
- dhe nëse ju bëni kërkesë, ai do të mund të jetë prezent në marrjet në pyetje dhe ballafaqimet.

- Periudha e ndërhyrjes:

-Duke pasur parasysh nevojat hetimore që kërkojnë marrjen tuaj në pyetje menjëherë, prokurori mund të autorizojë, me vendim të shkruar dhe të motivuar që marrja juaj në pyetje të fillojë pa pritur përfundimin e periudhës së parashikuar prej dy orësh për të lejuar ardhjen e avokatit tuaj.

- Ndërhyrja e avokatit tuaj mundet gjithashtu të shtyhet, për një kohëzgjatje maksimale prej 72 orësh, nëse ka arsye të pranueshme.

Asistenca e përkthyesit

Nëse ju nuk e flisni apo nuk e kuptoni frëngjishten, keni të drejtën të kërkonte asistencë falas nga një përkthyes gjatë marrjes suaj në pyetje dhe për të komunikuar me avokatin tuaj.

E drejta për të kërkuar përfundimin e mbajtjes nën arrest

Ju mund t'i kërkonte prokurorit ose gjyqtarit të hetimeve paraprake ose gjyqtarit të lirive dhe ndalimit, kur ai të deklarohet për një zgjatje të mundshme të mbajtjes nën arrest, që kjo masë të mos zgjatet.

Qasja në disa pjesë të dosjes suaj

Me kërkesën tuaj apo të avokatit tuaj, ju mund të kërkonte të shikoni, në rastin më të vonë përpara një zgjatjeje të mundshme të mbajtjes nën arrest:

- procesverbalin e njoftimit të vendosjes suaj nën arrest;
- certifikatën/-at mjekësore të nxjerra nga mjeku që ju ka vizituar.
- procesverbalin/-et e marrjes tuaj në pyetje